

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

PLAN-PROGRAM STUDIMOR (“SYLLABUS”)

SEMESTRI VEROR – VITI 2022

Profesori: Dr. Qerim Qerimi

Orët e ligjëratave: E hënë: 14:30 – 16:00

Në Amfiteatrin e Madh

Orët e konsultimeve: E hënë: 13:30 – 14:30 dhe me paracaktim

E-mail: qerim.qerimi@uni-pr.edu

PËRSHKRIMI I LËNDËS

Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë njohuri të përgjithshme dhe themelore për Organizatat Ndërkombëtare. Lënda e Organizatave Ndërkombëtare do t’u ofrojë studentëve mundësi që të zhvillojnë njohuritë e tyre për rregullat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me themelimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare. Konsideratë të veçantë do t’i jepet historikut të themelimit të organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe kompetencave të tyre, politikave dhe procesit të vendimmarrjes brenda këtyre organizatave.

Kjo lëndë është e disenjuar për studentët e studimeve themelore të Fakultetit Juridik. Periudha që trajtohet në këtë lëndë përfshinë shekullin e 19-të dhe deri te aktualiteti i sotëm në organizimin ndërkombëtar. Marrë parasysh periudhën e gjatë që trajtohet këtu, përqendrimi kryesor do të jetë në anën filozofike-politike dhe teorike, si dhe në sistemet kryesore të organizimit ndërkombëtar. Objektiv i lëndës është që të shpjegohen dhe kuptohen shkaqet dhe pasojat kryesore të organizimit ndërkombëtar, llojet e organizatave ndërkombëtare dhe natyra e tyre.

Si pjesë e kësaj lënde, studentëve do t’u ofrohet mundësia që të zhvillojnë njohuritë e tyre edhe për proceset e integritimeve evropiane, duke shqyrtuar me një vështrim të përgjithshëm Bashkimin Evropian si njëra prej organizatave më të suksesshme dhe më të rëndësishme në arenën ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë do të shqyrtohen edhe marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor nëpërmjet Procesit të Stabilizim-Asociimit. Kjo pjesë e lëndës do t’u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri edhe mbi sfidat praktike me të cilat ballafaqohet Ballkani Perëndimor, në përgjithësi, dhe Republika e Kosovës në veçanti. Studentët do të pajisen edhe me njohuri të përgjithshme mbi një mori organizatash dhe nismash të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Këshillin e Evropës, OSBE-në, NATO-n, dhe organizata të tjera të ngjashme.

Pjesa e fundit e lëndës do të përqendrohet në debatin bashkëkohor që ka të bëjë me rolin e organizatave ndërkombëtare në situatat e pas-konfliktit, në veçanti në rastin e Kosovës. Kjo pjesë do të trajtojë edhe procesin aktual të anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë një analizë dhe diskutim të kërkesave procedurale për anëtarësim në mekanizma kyç ndërkombëtarë, perspektivat për anëtarësim dhe problemet që mund të dalin në proces të anëtarësimit.

VLERËSIMI

Do të ketë një testim mes-semestral dhe një testim përfundimtar, që do të mbulojnë, përveç nëse u thuhet ndryshe, materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata dhe ushtrime. Vlerësimi do të jetë si në vijim:

- Testi mes-semestral: 40 për qind (%)
- Testi përfundimtar: 50 për qind (%)
- Pjesëmarrja aktive dhe e rregullt në ligjërata: 10 për qind (%)

Do të ketë një politikë rigorozë në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës dhe çfarëdo mungese, e jo më tepër se tri, do të trajtohet me kujdes të shtuar.

Si shtesë e metodës së vlerësimit të shpallur si më sipër, pjesëmarrja cilësore ose përmbajtjesore në diskutimet gjatë ligjëratave dhe/ose ushtrimeve mund të vlerësohet edhe me 10 për qind (%) të tjerë. Nëse pjesëmarrja, në cilësi dhe përmbajtje, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për të përcaktuar këtë i takon profesorit të lëndës.

Rezultati përfundimtar, pra, do të përcaktohet nga rezultati i akumuluar në dy provimet e organizuara gjatë semestrit (mes-semestral dhe përfundimtar) dhe cilësia e vijueshmërisë në ligjërata. Pavarësisht këtij vlerësimi, studentët kanë të drejtë që të paraqiten në provimin e rregullt në fund të semestrit (në afatin e qershorit). Sidoqoftë, në këtë rast, konsiderohet që paraprakisht kanë hequr dorë nga rezultati që kanë arritur nga vlerësimi i bërë gjatë gjithë semestrit akademik. Vetëm studentët që kalojnë testin mes-semestral, kanë të drejtë paraqitjeje në testin përfundimtar, që organizohet në ligjëratën e fundit të semestrit akademik.

Një minimum prej 55 për qind (%) është i nevojshëm për notë pozitive kaluese.

OBJEKTIVAT E LËNDËS

Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:

1. Kuptojnë dhe shpjegojnë strukturën institucionale ndërkombëtare, përfshirë fillet dhe zhvillimin e organizimit ndërkombëtar;
2. Kuptojnë dhe shpjegojnë rolin e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale në procesin e politikëbërjes dhe ligjëbërjes ndërkombëtare;
3. Njohin dhe kuptojnë aspekte specifike dhe/ose të specializuara të organizatave ndërkombëtare (siç është çështja e anëtarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare apo çështja e procedurave të vendimmarjes);
4. Të përfitojnë aftësi dhe shkathtësi analitike, argumentuese dhe kreative përmes analizës dhe diskutimit të rasteve dhe të teksteve ligjore.

KORNIZA PËRMBAJTJESORE

Organizatat Ndërkombëtare është një lëndë sfiduese pasi operon në një arenë politike dhe ekonomike që për nga struktura dhe dinamika dallon nga arena e brendshme e shteteve me të cilën studentët janë më të familjarizuar. Brenda kufizimeve dhe/apo kornizave të përcaktuara kohore, kjo lëndë do të përfshijë një numër të madh temash.

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë dhe të mundësisë për ndërveprim më të madh në klasë, rekomandohet fuqimisht që studentët të lexojnë paraprakisht materialet për temën, e cila do të diskutohet në orën(-t) pasuese, në mënyrë që të krijohet një kuptim i përgjithshëm dhe familjarizim me materialin dhe tërësinë e temave që do të diskutohen në ligjërata. Studentët do të njoftohen rregullisht për materialet që duhen lexuar për orët pasuese.

METODA

Me kalimin e kohës, metodat akademike ndryshojnë dhe përparojnë. Përqendrimi në mendimin kritik, analitik dhe kreativ do të jetë filozofia qendrore e organizimit dhe mbarëvajtjes së kësaj lënde. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet përmbajtjes së diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë orëve të ligjëratave të kësaj lënde.

Studentët inkurajohen që të lexojnë literaturë shtesë në mënyrë që të jenë në gjendje të analizojnë dhe kuptojnë problematikën e shtruar për diskutim përgjatë gjithë semestrit që i dedikohet kësaj lënde.

ORARI DHE PËRMBAJTJA E LIGJËRATAVE

Java e Parë:

HYRJE

Përmbajtja, organizimi dhe kërkesat e lëndës; metodologjia e mësimdhënies; dhe metoda e vlerësimit

Java e Dytë:

LINDJA E ORGANIZIMIT NDËRKOMBËTAR DHE KRIJIMI I ORGANIZATAVE TË PARA NDËRKOMBËTARE

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 345 - 350.

Material shtesë nga profesori i lëndës

Java e Tretë:

NOCIONI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE KLASIFIKIMI I TYRE (përfshirë Kongreset dhe Konferencat)

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 350 - 362.

Java e Katërt:

ORGANIZATAT E PËRGJITHSHME NDËRKOMBËTARE I: LIDHJA E KOMBEVE

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 363 - 367.

Java e Pestë:

ORGANIZATAT E PËRGJITHSHME NDËRKOMBËTARE II: SISTEMI I KOMBEVE TË BASHKUARA – STRUKTURA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 367 - 391.

Java e Gjashtë:

ZHVILLIMI I OKB-SË PARA, GJATË DHE PAS VITEVE TË LUFTËS SË FTOHTË: REZULTATI DHE REFORMA

Literatura:

Material i përgatitur nga profesori i lëndës

Java e Shtatë:

TESTI MES-SEMESTRAL

Java e Tetë:

KAPACITETI LEGJISLATIV I OKB-SË DHE PERSONALITETI I SAJ LIGJOR (përfshirë interpretimin e Kartës së OKB-së)

Literatura:

Material i përgatitur nga profesori i lëndës

Java e Nëntë:

BASHKIMI EVROPIAN DHE ORGANIZATAT E TJERA EVROPIANE

Elementët që paraqesin ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet këtyre mekanizmave

Literatura:

Bashkim Zahiti, “*E Drejta Evropiane*”, faqe 13-18.

Blerim Reka dhe Arta Ibrahim, “*Studime Evropiane*”, faqe 45 – 55.

Fausto Pocar, “*E drejta e Komuniteteve Evropiane*”, faqe 6 – 11.

Paul Craig and Grainne De Burca, “*EU Law: Text, Cases and Materials*”, faqe 3-54.

Japophine Steiner, Lorna Woods, Christian Twigg – Flesner, “*EU Law*”, faqe 3-20.

“*Libri i Bardhë për Përgatitjen e Vendeve të Asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore për Integrimin në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian*”

Në dispozicion tek:

<http://mie.gov.al/skedaret/1158676591-Libri%20i%20Bardhe.pdf>

“*Glosar për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*”

Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/glosar_per_integrimin_europian.pdf

“15 Pyetje për Bashkimin Evropian”

Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/1199717851-15_pyetje_be.pdf

<http://www.coealb.org/>

<http://www.oecd.org>

<http://www.nato.int/>

<http://www.osce.org>

<http://www.osce.org/kosovo>

<http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>

Java e Dhjetë:

ORGANIZATAT RAJONALE

- 1) *Organizata e Shteteve Amerikane*
- 2) *Bashkimi Afrikan*
- 3) *Liga Arabe*
- 4) *Pakti Veriatlantik (NATO)*
- 5) *Traktati i Varshavës*

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 392 - 407.

Java e Njëmbëdhjetë:

INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA

Literatura:

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, fq. 407 - 416.

Java e Dymbëdhjetë:

ORGANIZATAT JOQEVERITARE DHE INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE JOFORMALE

Literatura:

Material i përgatitur nga profesori i lëndës

Java e Trembëdhjetë:

ROLI I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË (Mekanizmat e OKB-së, OSBE-së, NATO-s, BE-së) & ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Java e Katërbëdhjetë:

TESTI PËRFUNDIMTAR

LITERATURA

Literatura themelore:

- Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, *Pjesa e Gjashtë: Organizatat Ndërkombëtare* (Prishtinë, 2007).
- *Materiale të përgatitura ose përmbledhura nga profesori i lëndës, dhe të dorëzuara në kohë që lejon hapësirë të mjaftueshme për studim përpara ligjëratës përkatëse.*

Literatura e Rekomanduar:

- Margaret P. Karns & Karen A. Mingst, *The Politics and Processes of Global Governance* (2nd ed., 2009).
- Jan Klabbers, *An Introduction to International Institutional Law* (2nd ed., 2009).
- Paul F. Diehl & Brian Frederking, *The Politics of Global Governance: International Organizations in an Interdependent World* (2010).
- Qerim Qerimi, *An Informal World: The Role and Status of “Contact Group” under International Law*, 7 *Chicago-Kent Journal of International and Comparative Law* 117 (2007).
- Fausto Pocar, “*E drejta e Kominiteteve Evropiane*”, 1998.
- Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian

“*Libri i Bardhë për Përgatitjen e Vendeve të Asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore për Integrimin në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian*”

Në dispozicion tek: <http://mie.gov.al/skedaret/1158676591-Libri%20i%20Bardhe.pdf>

“*15 Pyetje për Bashkimin Evropian*”

Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/1199717851-15_pyetje_be.pdf

“*Glosar për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*”

Në dispozicion tek: http://mie.gov.al/skedaret/glosar_per_integrimin_europian.pdf

Vërejtje:

Ju lutem vëreni se ky është një *projekt* plan-program dhe mund të ndryshohet, përmirësohet apo përshtatet gjatë zhvillimit të lëndës për qëllime të rezultatit më të mirë të studentëve. Për çfarëdo ndryshimi të mundshëm, njoftimi do të bëhet në kohën e duhur.